



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 31.01.2019)

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10: 34 dhe mbaroi në orën 10:52.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-----------------------------|--------------------------|
| <i>1. Naureda Llagami</i> | <i>(kryetare)</i> |
| <i>2. Maksim Qoku</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>3. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>4. Medi Bici</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>5. Brunilda Kadi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>6. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Ilir Toska</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>10. Erjon Muharremaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>11. Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë institucionit.*
- 2. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
- 3. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
- 4. Elis Kuçi, Zëdhënës pranë institucionit.*
- 5. Përfaqësues të Ambasadës Amerikane.*
- 6. Përfaqësues të USAID-it.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projekt-vendimit të KLGJ-së “Për një shtesë në vendimin nr. 17, datë 29.01.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Mbi numrin e kandidatëve që do të pranohen në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2019 - 2020”.

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Në radhë të parë ju kërkoj ndjesë për urgjencën e kësaj mbledhjeje.

Në fillim prezenca. Janë të gjithë anëtarët.

Urgjenca e kësaj mbledhjeje erdhi si rezultat i komunikimit me Shkollën e Magjistraturës, lidhur me vendimin që ne morëm një ditë përpara.

Shqetësimi që ato ngritën ishte lidhur me pjesën e tarifave, duke qenë se Shkolla e Magjistraturës aplikon një tarifë për konkursin dhe është një tarifë në një vlerë të caktuar dhe fakti që neve... sepse rregullorja e tyre e ka të parashikuar për magjistratët, ndërkohë që për këshilltarët dhe ndihmësit, ne duhet që ta përcaktonim tek projekt-vendimi ynë dhe ato na sugjeruan, kuptohet, me shumë urgjencë, që ne ta reflektonim këtë gjë, për mundësinë e pagesës në testimin që do kryhet, edhe për ndihmësit dhe për këshilltarët ligjorë.

Kështu, duke qenë se Shkolla e Magjistraturës ka detyrimin që t’i publikojë listat brenda janarit, ishim të detyruar që të reagonim sa më shpejt me vendimmarrjen për

korrigjimin e këtij vendimi. Duke qenë se e futëm në pjesë korrigjimi për këtë çështje, reflektuam edhe një sugjerim tjetër që kishte lidhje me kriteret, për ta saktësuar më shumë në vendimin e marrë.

Për më shumë detaje, po ia kaloj fjalën kryetarit të Komisionit të Karrierës, prej të cilës vjen.. nga i cili vjen dhe propozimi.

Ilir Toska: Ju faleminderit!

Atëherë, siç tha edhe Kryetarja e Këshillit, pasi ne miratuam vendimin dhe ia çuam për zbatim edhe Shkollës së Magjistraturës, Shkolla e Magjistraturës konstatoi që kishte një ometim nga ana jonë sa i përket një prej kriterëve, ndërsa kishim përcaktuar dokumentacionin në mënyrë shteruese që duhet të paraqisnin kandidatët. Një prej dokumenteve nuk reflektonte një kriter të caktuar tek kriteret e përgjithshme, ishte pikërisht deklarata për mosqenie anëtar i një partie politike, që nga ana tjetër, në pikën 6, nuk reflektonte një kriter, që kandidati për këshilltar apo ndihmës ligjor nuk duhet të jetë anëtar i një partie politike.

Nisur nga ky ometim, konsideruam që të bëjmë propozim dhe të plotësojmë këtë mangësi që kemi lënë në vendimin që kemi miratuar tashmë.

Nga ana tjetër, shkolla na referoi faktin se për pjesëmarrjen në konkurs, sipas rregullores së saj të brendshme, paguajnë një tarifë për pjesëmarrjen në konkurs. E konsideronte të nevojshme që ne, sa kohë kishim marrë përsipër që të përcaktonim në mënyrë të detajuar kriteret, dokumentacionin, të reflektohej në vendimin tonë edhe fakti që kandidati për këshilltar apo për ndihmës ligjor që do të pranohej në provimin e pranimit për formimin fillestar, kishte edhe një detyrim ligjor që ishte ai i tarifës për pjesëmarrjen në konkursin e pranimit. Këtë gjë e kemi reflektuar në një propozim që kemi bërë për shtesën e vendimit nr. 17.

Sa i përket kriterit “nuk është anëtar i një partie politike në kohën e kandidimit”, kemi konsideruar që të shtojmë një pikë /i/: “i) nuk është anëtar i një partie politike në kohën e kandidimit”, ndërkohë që në pikën 8, ku flitet për procesin e regjistrimit në bashkëpunim me shkollën, kemi sugjeruar që të shtohet edhe një paragraf tjetër ku të reflektohet pikërisht formulimi: “Kandidatët për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë që plotësojnë kriteret, i nënshtrohen konkursit të pranimit, duke paguar tarifën e regjistrimit

për pjesëmarrjen në konkurs sipas Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës”.

Ky ishte pak a shumë propozimi.

Lidhur me propozimet që ka bërë Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, kemi diskutuar edhe paraprakisht me gjithë kolegët. Kemi përshtypjen që kanë ndarë të njëjtin qëndrim. Gjithsesi, nëse ka ndonjëri një pyetje, mund të japim një shpjegim të caktuar.

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Ndonjë diskutim për çështjen?

Medi Bici: Unë kisha një diskutim, zonja Kryetare!

Tek ky projekt-vendim unë e bëra një pyetje, për pikën /d/, për notën mesatare. Me thënë të drejtën, nuk e votova kundër vendimin, se me arsyetimin u tha, që nuk kemi ku t’i gjejmë.

Tani na erdhi për t’u korigjuar akti, por nëse ky akt do të na ishte dhënë dy-tre ditë përpara, ne të paktën të... që mos të jesh i dënuar me vendim penal të formës së prerë duhet ta kishim azhurnuar. Kurse kjo pjesa që është në rregulloren e Shkollës së Magjistraturës, nuk kam ndonjë vërejtje, por jo se kam ndonjë merak të madh, por kjo nota mesatare do më ngeli dhe unë e kam votuar, por kam frikë se mbas 2 vjetësh, këto këshilltarë ose ndihmës ligjorë do të na vijnë si kandidatë për në Shkollën e Magjistraturës, dhe e deklaroj që sot vota ime do të jetë kundër këtyre, për t’u pranuar si studentë të Shkollës së Magjistraturës.

Prandaj, meqenëse jemi, nëse mund ta ndryshojmë edhe mendojeni, hidheni për diskutim, ose nëse ngelemi vetëm, nuk është problem.

Alban Toro: Më fal, për çfarë profili bëhet fjalë?

Medi Bici: Për pikën /d/.

Alban Toro: Jo, jo, për çfarë profili? Për çfarë do vijnë këta nga Shkolla e Magjistraturës? Për profilin gjyqtar e ke merakun?

Medi Bici: Këto do vijnë si këshilltarë fillimisht (siç ishin të tjerët që u bënë) dhe pastaj u pranuan pa notë mesatare 8 dhe u futën si studentë në Shkollën e Magjistraturës.

Alban Toro: Do kandidojnë për gjyqtarë më pas, e ke hallin?

Medi Bici: Mbas 1 viti, mbas 2 vjetësh.

Alban Toro: S'e ka ligji.

Naureda Llagami: Zoti Toska, mund të sqarosh?

Ilir Toska: Kam përshtypjen që zoti Bici ka merakun nëse në një të ardhme, kandidatët për këshilltarë apo ndihmës ligjorë mund të konkurrojnë për magjistratë. Në fakt, kriterin e notës për magjistratë nuk e përcakton Këshilli. Nuk është çështje e Këshillit kriteri i notës për magjistratë. Ne kemi detyrimin të përcaktojmë kriteret.

Medi Bici: Kriteri i notës është i përcaktuar për të gjitha: për doktoratura, për magjistraturën, për të shkuar në Gjykatën Kushtetuese, është nota mesatare 8. Frika ime është kjo, se duke u pranuar në sistem këshilltarë të tillë, kur ne kemi me dhjetëra, me dhjetëra studentë që i kemi ndërmjet mesatares 9-10. Frika ime është që në të ardhmen do të kalojmë të pranojmë këto studentë nën mesataren 8 (si studentë të Shkollës së Magjistraturës).

Ilir Toska: ... mendoj se qenia këshilltar apo ndihmës ligjor përmbush kriteret për të konkurruar për kandidat për magjistrat në rast nuk plotëson kriteret që ligji kërkon për magjistratët.

Naureda Llagami: E kalojmë në votim projekt-propozimin nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (projekt-aktin)?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Dakord.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, projekt-akti është miratuar sipas përmbajtjes së propozuar nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Ndonjë çështje tjetër për diskutim?

Atëherë, ju falenderoj për pjesëmarrjen dhe për prezencën tuaj.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor